



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 160

Tiranë – E premte, 29 nëntor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile nr. 1, datë 29.11.2019	Për caktimin e drejtuesve qendrorë të operacionit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë..... 12893

**VENDIM****Nr. 1, datë 29.11.2019****PËR CAKTIMIN E DREJTUESVE
QENDRORË TË OPERACIONIT PËR
MENAXHIMIN E FATKEQËSISË
NATYRORE NË QARQET DURRËS
DHE TIRANË**

Në mbështetje të nenit 19 të ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe vendimit nr. 750, date 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore në qarkun e Durrësit dhe të Tiranës, i mbledhur sot më datë 29.11.2019,

VENDOSI:

1. Caktimin si drejtues qendror të operacionit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore në qarkun e Durrësit të z. Bledar Çuçi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Caktimin e znj. Rovena Voda, zëvendësministër i Brendshëm, me detyren e të deleguarit të KNEC për qarkun Durrës për çështjet operacionale.

3. I deleguari i KNEC për qarkun Durrës për çështjet operacionale, drejton dhe koordinon në nivel qendror, strukturat operacionale për përballimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, në qarkun e Durrësit.

4. Drejtuesit qendror të operacioneve për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi ngarkohen në emër dhe për

llogari të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile me detyrat e mëposhtme:

a) Të drejtojnë dhe bashkërendojnë gjithë veprimtarinë e institucioneve dhe të strukturave të mbrojtjes civile në qarkun e Durrësit dhe të Tiranës;

b) Të përcaktojnë mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale e financiare në qarkun e Durrësit dhe të Tiranës;

c) Të marrin vendime mbi shpërndarjen e fondeve për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore në qarkun e Durrësit dhe të Tiranës;

ç) Të përcaktojnë mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale e financiare në qarkun e Durrësit dhe të Tiranës;

d) Të kryejnë çdo detyrë tjetër që buron nga ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe detyra të veçanta të caktuara nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile.

5. Të gjitha aktet e nxjerra në zbatim të detyrave sipas pikës 4 të këtij vendimi, miratohen nga KNEC.

6. Drejtuesit qendror të operacioneve për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore asistohen nga stafe teknike nga strukturat që ato drejtojnë.

7. Të gjithë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, enteve publike dhe atyre private, të angazhuar në këtë situatë të fatkeqësisë natyrore janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e drejtuesve qendrorë të operacioneve për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore për qarqet e Durrësit dhe të Tiranës, si dhe të raportojnë pranë tyre sa herë u kërkohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 28 lekë